



KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA

Procesverbal i mbajtur më 30 mars 2026, në mbledhjen e III-të (tretë) -e rregullt, mandati VIII-të i Komitetit për Politikë dhe Financa.

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit në ndërtesën e re të Komunës, dhe filloi në orën 10:25.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z.Isak Shabani, Kryesues i Kuvendit, përkatësisht i këtij Komiteti.

Fillimisht u konstatua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e këtij Komiteti, dhe atë; (Isak Shabani, Haki Rudari, Artrit Mulliqi, Adelinë Stublla, Qëndresë Hajrizi, Alisa Jetullahu, Enis Shabani, Ekrem Rrahmani, Mimoza Abdullahu,), lista e nënshkrimeve.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje i pranishëm nga Ekzekutivi i Komunës ishin; z.Fahri Restelica Nënkryetar i Komunës, Arbnorë Uka Osmani U.D. drejtoresh e Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave-DBF; Lirie Hoti Rama U.D. drejtoresh e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale-DSHMS; Saranda Stublla Uka U.D. drejtoresh e Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë-DPKGJ,

Rendi i ditës

z.Isak Shabani, Kryesues i Komitetit, e hapi mbledhjen duke përshëndetur të pranishmit, konstatoi kuorumin, ndër të tjera theksoi, në bazë të njoftimit të dërguar dhe materialeve të shpërndara paraprakisht konstatojmë se të gjithë anëtarët e KPF-së janë prezent andaj njëkohësisht konstatoj se kemi kuorum për punë dhe vendimmarrje, prandaj e shpall të hapur këtë mbledhje të sotme.

Siç e cekta edhe në fillim, ju e keni marrë materialin e kësaj mbledhje, por para se të hedh rendin e ditës në votim ju njoftoj se është sjellë edhe një propozim shtesë nga Kryetari i Komunës për ta përfshijë në kuadër të rendit të ditës, pikë të cilën do ta prezantoj Nënkryetari i Komunës.

z.Fahri Restelica, Nënkryetar i Komunës, theksoi, në emër të Kryetarit të Komunës e kemi edhe një propozim vendim për ngritjen e Komisionit Komunal të Aksionareve të Ndërmarrjes Publike për Banim – Podujevë, kjo pra është pikë shtesë që do të thotë se nëse mbështetet që të hyjë si pikë shtesë, do t'i bashkëngjitet rendit të ditës dhe pikave përkatëse tjera të kësaj natyre për Ndërmarrje tjera publike.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, përse nuk ka ardh me kohë kjo pikë e rendit të ditës kur e dim se ekziston kjo Ndërmarrje në listën ku Komuna është akisonare 100%, por kanë vendos që sot ta sjellin në këtë formë 1 ditë para seancës së Kuvendit. Pse nuk ka ardh në fillim nëse ka mundësi të na sqaroni, çka ka pasë problem me këtë Ndërmarrje që nuk ka ardh me kohë.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, siç jemi në dijeni Komuna e Podujevës ka 4 Ndërmarrje publike komunale por ka qenë një gabim teknik që kjo pikë që është propozuar sot, nuk ka hyrë në rend të ditës për këtë mbledhje të KPF-së dhe për mbledhjen e nesërme të Kuvendit, prandaj nuk besoj se ka diçka të keqe që ka ardh sot dhe se nuk kërkohet ndonjë parapërgatitje e veçantë për këtë pikë të rendit të ditës sepse besoj e dim kuptimin e këtyre propozim vendimeve sikurse kuptimin e këtyre çështjeve.

Atëherë nuk ka të lajmëruar tjerë për të marrë fjalën unë e hedh në votim fillimisht propozimin e Kryetarit të Komunës për të shtuar një pikë të rendit të ditës që është kërkesa për përfshirje në kuadër të rendit të ditës edhe propozim vendimi për ngritjen e Komisionit Komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike për Banim, e pastaj e hedhim rendin e ditës si tërësi.

z.Artrit Mulliqi, theksoi, sa vërejtja në propozim vendim janë vetëm dy anëtarë që duhet të emëron nga Kuvendi i Komunës, kurse në këto Komisione duhet të jenë tre anëtarë, pra edhe një anëtar nga Ekzekutivi i Komunës, prandaj mendoj se është mirë që të definohet kjo çështje.

Kryesuesi i Komitetit, pasi u dhan sqarimet parafolësit se ajo që kërkoj ai është e rregulluar në paragrafin 2 të nenit 1 të propozim vendimit sikurse edhe në propozimet tjera që janë të kësaj natyre në këtë mbledhje, vazhdoi duke kërkuar që të votohet tani.

Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se nga 9 anëtarët e Komitetit, me 7 vota PËR, asnjë votë KUNDËR, asnjë votë TË PËRMBAJTUR, (të tjerët nuk votuan), mbështetet propozimi Kryetarit të Komunës, dërguar me shkrim Kuvendit të Komunës përmes Kryesuesit të Kuvendit, prezantuar nga Nënkryetari i Komunës z.Fahri Restelica, që në kuadër të rendit të ditës (pikë e 12) në këtë mbledhje të përfshihet edhe pika shtesë:

- Propozim vendimi për ngritjen e Komisionit Komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike për Banim Sh.A. Podujevë

z.Isak Shabani, Kryesues i Komitetit, vazhdoi, tani e hedh në votim në tërësi rendin e propozuar të ditës, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Njëzëri me 9 vota PËR, miratohet rendi i ditës sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes, përfshirë edhe pikën shtesë e cila u mbështet paraprakisht, dhe atë sipas materialit përkatës të prezantuar dhe shpërndarë në fillim të mbledhjes.

1. Procesverbalet nga mbledhjet e Komitetit për Politikë dhe Financa, të mbajtura më: 28 janar 2026 dhe 25 shkurt 2026

z.Isak Shabani, Kryesues i Komitetit, theksoi, në këtë pikë kemi dy Procesverbale të dy mbledhjeve paraprake të Komitetit për Politikë dhe financa, andaj fillimisht ju ftoj ta merrni fjalën nëse ndokush dëshiron dhe ka diçka rreth tyre, nëse jo atëherë i hedh në votim ashtu siç janë dërguar.

-Pas votimit Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Njëzëri me 9 vota PËR, miratohet, pa vërejtje apo ndryshim plotësime, Procesverbali nga mbledhjet e Komitetit për Politikë dhe Financa, të mbajtura më 28 janar 2026

-Pas votimit Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Njëzëri me 9 vota PËR, miratohet, pa vërejtje apo ndryshim plotësime, Procesverbali nga mbledhjet e Komitetit për Politikë dhe Financa, të mbajtura më 25 shkurt 2026

2. Raporti Vjetor Financiar i Komunës së Podujevës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025

znj.Arbnorë Uka - Osmani, U.D. drejtoresh e DBF, e paraqiti fjalën hyrëse rreth këtij raporti, theksoi, meqë është hera e parë që marrë fjalën si udhëheqëse e DBF, shpresoj që do të kemi punë të mare dhe bashkërisht do t'i përmbushim kërkesat e qytetarëve.

Sikurse çdo vit tjetër edhe në këtë vit, bazuar në Ligjin për menaxhimin e financave publike, deri më 31 mars jemi të obliguar që të paraqesim para juve Raportin Financiar. Herë pas herë kemi pasë kërkesa për prezantim të këtij raporti por meqë kemi qenë në pritje të Thesarit për të gjitha korrigjimet. Nuk ka qenë e mundur dërgimi i draft raportit financiar pa qenë final. Po besoj se materialin e keni pranuar të gjithë.

E dim se Raporti Financiar paraqet të gjitha të hyrat dhe shpenzimet gjatë vitit fiskal, në këtë rast të vitit 2025, atëherë bazuar në shënimet që kemi dhe buxhetin fillestar që ka qenë për vitin 2025 në shumë rreth 33,459, 000.00€ ndërsa buxheti final ka qenë 36,495.000.00€, kurse realizmi apo shpenzimet i gjithë buxhetit të vitit 2025 është realizuar në shumë afërsisht 35,581,000.00€ apo shprehur në përqindje 98%.

Prej tyre pjesën më të madhe e kanë pagat dhe shtesat ku 19,222,217.00€ janë shpenzuar 19,205,159€ apo 99.91% dhe kjo një pjesë prej grantit qeveritar dhe një pjesë shumë të vogël prej të hyrave vetanake.

Për mallra dhe shërbime në buxhet kanë qenë 4,097,234.00€ ndërsa janë shpenzuar 4,062,325.00€ ku prej grantit qeveritar kanë qenë 4,006,481.00€ ndërsa prej të hyrave vetanake 55,844.00€ shprehur në përqindje realizimi ka qenë 99%.

Te shpenzimet komunale nuk ka ndonjë ndryshim prej buxhetit fillestar dhe atij përfundimtar, dhe kuptohet është realizuar 100% buxheti në këtë kategori.

Për Transfere dhe subvencione, buxheti i aprovuar ka qenë 2,099,889.00€ kurse shpenzimet për transfere dhe subvencione kanë qenë 1.837,845.00€, shprehur në përqindje 89%, prej tyre nga granti qeveritar 827,906.00€ ndërsa prej të hyrave vetanake 770,991.00€, por që ka pasë shpenzime edhe nga donacionet në shumë 238,948.00€.

Te shpenzimet kapitale, buxheti final ka qenë 10,395,811.00€ ndërsa është shpenzuar 9,841,927.00€ shprehur në përqindje 96%, ndërsa prej grantit qeveritar i kemi të shpenzuara 8,473,730.00€ kurse prej të hyrave vetanake 1,280,067.00€ dhe prej Klauzolës investive 88,130.00€.

Shpenzime tjera siç e dim nuk kemi pasë, marrë në përqindje total realizmi i buxhetit është, 98% në vitin 2025, por pavarësisht kësaj kemi edhe detaje tjera mirëpo nëse keni diçka rreth kësaj do të vazhdoja të diskutojmë edhe nesër në seancën e Kuvendit, kjo pasi që është hera e parë e imja në cilësinë e udhëheqëses së DBF andaj nuk po e di a të zgjerohem më shumë te kjo pikë apo jo. Si do qoftë ju falënderoj të, gjithëve për vëmendjen.

z.Haki Rudari, theksoi, ne para vetës kemi një raport vjetor financiar për vitin 2025 që do të thotë se raporti apo raportimi është një mekanizëm përmes të cilit këshilltarët e Kuvendit por jo vetëm ne mirëpo në përgjithësi qytetarët duhet të njihen lidhur me natyrën e shpenzimeve të buxhetit të Komunës tonë.

Te raporti, në nenin 13 kemi një pasqyrë të pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme për vitin 2025 dhe nga ajo që u përmendën shumat dhe shifrat nga ana e drejtoreshës parafolëse, unë do të ndalem vetëm te totali i shpenzimeve për vitin 2025, pra janar - dhjetor. Pra kemi një shpenzim prej 35,580,856.00€, nga kjo shumë paraja më e madhe ka shkuar për paga dhe mëditje, si dhe një numër i madh ose miliona euro ka shkuar për investime kapitale respektivisht 9.842,000.00€ për investime kapitale, marrë në përgjithësi, pra ky buxhet prej mbi 35 milion euro, realisht ka shkuar nëpër sektor të ndryshëm e që unë shpesh herë e them se secili sektor i ka ato interesat e veta qytetare, andaj në emër të Grupit të LVV-së ne e përkrahim këtë pikë të rendit të ditës dhe e rekomandojmë për shqyrtim në seancën e Kuvendit, e që nesër në Kuvend besoj që ndoshta do të jemi pak më gjerësisht dhe do të merremi ndoshta edhe me detaje që ndërlidhen me këtë raport financiar të Komunës së Podujevës për vitin 2025.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, për mua ky raport nuk është real në asnjë pikë, nuk e di çfarë kanë shkruar këtu dhe nuk merret vesh sepse është shumë i mangët, madje është goxha raport i rrejshëm. E them këtë sepse unë zakonisht e marrë raportin e free balance në DBF por edhe në Ministri të Financave kur nuk na e japin Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, pra këtu nuk pasqyrohet asgjë, shembull ne nuk po e dim a po shkojmë përpara apo po kthehemi mbrapa sepse po të hymë dhe t'i shikojmë raportet të viteve 2015, 2017, 2019 e që nesër do ta shtypi dhe t'ju tregoj qysh bëhet raporti shembull ai i vitit 2019, qysh pasqyrohen gjitha parat që ta dinë qytetarët ku po shkojnë dhe kush po i merr, e jo kështu siç është ky që as nuk ka krahasim me vitet paraprake as grantet as shpenzimet që të tregohet sa kanë qenë dhe sa janë shpenzuar. Qytetarët e meritojnë ta dinë kah po shkojnë këto para, kujt po i jepen këto para, përse po i'u jepen ato para dhe qysh po ndahen këto para, dhe nëse atyre nuk i'u vie marre t'i marrë përse tek ne qenka marre t'i qitet emri atij që merr para.

Unë kam raportet të gjitha, pagesat prej 01 janarit 2025 deri më 31 dhjetor 2025, kush ka marrë para nga Komuna, dhe tani kjo duhet të sqarohet këtu përse i kanë marrë ato para. Unë kam shtyp edhe i kam këtu disa nga raporti i free balance ku ka shumë njerëz, dhe po të shikohen tani pagesat se kush merre para nga Komuna, dhe të shikojmë atë që parafolësi z,Haki Rudari e tha që e përkrahin këtë raport duke e lavdëruar atë, unë besoj që ku t'i sheh ai se kush ka marrë ato para pa pikë lidhje, mendoj se edhe ai do të del kundër, por ajo që është më interesantja, është se në këtë raport nuk merret vesh gjë, andaj do të duhej të ishte më i thjeshtë të tregohen arsyet e pagesave, ky është paguar për atë, aj është paguar më këtë..., e jo 12 fletë raport, janë shpenzuar kaq për kanalizim, kaq për mirëmbajtje edhe asgjë, prandaj raporti do të duhet të jetë i kuptueshëm, e këtë që e kemi jo qytetarët po vetëm duhet të jetë i kësaj lëmie që ta merr vesh se çka thuhet këtu sepse është raport i cili nuk tregon asgjë hiq.

Unë po e bëjë fajtores drejtoreshën e DBF-së sepse nuk ka qenë në atë kohë drejtoresh dhe nuk e besoj që e ka përgatit kjo fare këtë raport sepse tash vonë ka ardh drejtoresh, mirëpo çka mund të them është se kjo mënyrë e raportimit është katastrofë, nuk duhet të jetë kështu sepse gjithë ky buxhet prej mbi 36 milion euro të shpenzohet dhe të mos e dim ne kah po shkojnë , të ndahen para sikur të jenë të fituara në bingo ku kë ta takosh në rrugë t'i jepet para, kjo është tmerr.

Unë nuk e përkrahi këtë raport, do të votoj kundër dhe nesër në seancën e Kuvendit do të dal dhe do t'i përmendi pagesat dhe pastaj kushdo që dëshiron dhe që ka interesim t'i marrë ato raporte, qoftë edhe nga pozita që të shohin pastaj se këta dalin ngajnë pas partie dhe punojnë kurse paratë i merr dikush tjetër, e mandej të dalin këta dhe të japin përkrahje këtij raporti.

znj.Arbnorë Uka - Osmani, U.D. drejtoresh e DBF, meqë nuk u specifikua diçka më specifike, por ishte si koment në përgjithësi, por besoj që nesër do të diskutojmë më në detaje në lidhje me këtë raport.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, pasi që po vërej se nuk të lajmëruar tjerë për diskutim, e hedh në votim që ky raport t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim në mbledhjen e caktuar për nesër.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit dhe Komitetit për Politikë dhe Financa konstatoi se nga 9 anëtarët e Komitetit, me 6 vota PËR, 3 vota KUNDËR asnjë votë TË PËRMBAJTUR, Kuvendit të Komunës i rekomandohet për diskutim të këtij Raporti, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

3. Propozim vendim për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës-Njësitë kadastrale P-00706-0 dhe P-00704-0, Zona Kadastrale Llapashticë e Poshtme

3.1. Propozim vendimi për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim

znj.Saranda Stublla - Uka, U.D. drejtoresh e DPKGJ, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, theksoi, në këtë pikë të rendit të ditës kemi propozim vendimin për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës, Njësitë kadastrale 706-0 dhe 704-0 në Zonën Kadastrale Llapashticë e Poshtme. Po ashtu për këtë parcelë si propozim vendim e kemi edhe formimin e komisionit për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim, andaj kërkoj nga ana juaj që ta përkrahni dhe t'ia rekomandoni Kuvendit për aprovim.

znj.Adelinë Stublla, theksoi, në emër të Grupit të LVV-së i rekomandojmë Kuvendit për shqyrtim.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, unë edhe për këtë pikë të rendit të ditës jam kundër, arsyeja pse jam kundër është dhënia afatgjatë për 99 vite e që mendoj se Komuna nuk duhet të falë tokë, dhe nuk duhet që ne gjeneratave të ardhshme t'jua lëm peng për 99 vite që dikush ta merr falë tokën dhe dikush të hyjë në procesverbal pas 10-15 viteve dhe të shaj mua çfarë kam votuar për dhënie në shfrytëzim të tokës për 99 vite. Ka afate tjera dhe ka mund të jetë shembull afatgjatë por për 30 vite e jo për 99 vite sepse kjo është për t'ia falë, prandaj unë jam kundër, madje jam "full" kundër.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën për këtë pikë të rendit të ditës, nëse jo atëherë e hedh në votim që kjo pikë e rendit të ditës t'i dërgohet kuvendit për shqyrtim.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit dhe Komitetit për Politikë dhe Financa konstatoi se nga 9 anëtarët e Komitetit, me 6 vota PËR, 3 vota KUNDËR asnjë votë TË PËRMBAJTUR, Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim të këtij Propozim vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës-Njësitë kadastrale P-00706-0 dhe P-00704-0, Zona Kadastrale Llapashticë e Poshtme (pika 3), sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, si rregull është që për miratime të tilla paraprake të ketë edhe formim të komisioneve për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim, pra në momentin që miratohen propozime të tilla atëherë duhet të formohet edhe komisioni në fjalë, andaj ftoj drejtoreshën e DPKGJ që të marrë fjalën për këtë rast e që besoj se kjo do të vlej pastaj edhe për të gjitha pikat tjera të tilla në vijim.

znj.Saranda Stublla - Uka, U.D. drejtoresh e DPKGJ, theksoi, sa i përket propozim vendimeve për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim, siç e dim këto komisione përbehen prej asambleistëve, Ekzekutivit dhe prej OJQ-ve. Ne si Drejtori kemi bërë thirrjen publike me kohë për OJQ-të dhe sot është, afati i fundit për aplikim andaj ata që do të aplikojnë do t'i prezantojmë nesër në mbledhjen e Kuvendit të Komunës kur për secilin/lën do t'jua sjellim CV-të dhe Letrat motivuese të tyre sipas aplikimeve.

z.Haki Rudari, theksoi, drejtoresha parafolëse e sqaroj por ne sigurisht që nesër do të propozojmë anëtarët e Komisioneve në fjalë për arsye se janë gjithsej 4 propozime të tilla dhe në çdo komision duhet të jenë nga 2 anëtarë nga radhët e Kuvendit, 2 nga Ekzekutivi dhe 1 nga OJQ, kështu që nesër në seancë do t'i propozojmë emrat ne dhe partitë tjera sigurisht.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, prandaj edhe këtë propozim vendim e hedh në votim që t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim, respektivisht formimin e komisionit në fjalë nga pika 3.1.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit dhe Komitetit për Politikë dhe Financa konstatoi se nga 9 anëtarët e Komitetit, me 6 vota PËR, 3 vota KUNDËR asnjë votë TË PËRMBAJTUR, Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim të këtij Propozim vendimi për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim (pika 3.1), sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

4. Propozim vendim për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës-Njësia kadastrale P-202-3, Zona Kadastrale Lupç i Poshtëm

4.1. Propozim vendimi për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave për dhënie në Shfrytëzim

znj.Saranda Stublla - Uka, U.D. drejtoresh e DPKGJ, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, theksoi, pra në këtë pikë të rendit të ditës po ashtu kemi Propozim vendimin për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës-Njësia kadastrale P-202-3, Zona Kadastrale Lupç i Poshtëm. Po ashtu kemi edhe pikën tjetër që është Propozim vendimi për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim, andaj kërkoj nga ana juaj që ta përkrahni dhe t'ia rekomandoni Kuvendit për miratim.

znj.Qëndresë Hajrizi, theksoi, në emër të grupit të LVV i'a rekomandojmë Kuvendit për shqyrtim të këtyre dy propozim vendimeve sipas kësaj pike të rendit të ditës.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, për këtë parcelë ne kemi pas edhe seanca tjera në të kaluarën, aty janë afër 38 hektar të cilat duan të falën për 99 vite, mirëpo unë kam një pyetje për drejtoreshën e DPKGJ sepse edhe ne dim që edhe Kryetari i Komunës në Televizion publik e ka thënë që këtë pronë e ka dhënë në shfrytëzim Kuvendi dhe do të ndërtohet Fabrikë e Autobusëve, e që nëse ndokush nuk e ka dëgjuare mund t'jua lëshoj një incizim të asaj që e ceka, mirëpo pyetja për drejtoreshën e DPKGJ është përse nuk është sjellë kjo me negocim të Kryetarit. Po e lexoj çka thuhet në Ligjin për dhënie në shfrytëzim, që ka të drejtë Kryetari i Komunës të jap prona në shfrytëzim me negocim e që nuk keni pas nevojë ta sjellni fare këtu tani por vetëm për miratim final është dashtë, nëse veç është e përcaktuar se kujt do t'i jepet dhe që do të ndërtohet Fabrikë aty, pra përse të futet në konkurrencë ai biznes.

Ligji 06/L-092 për dhënie në shfrytëzim dhe këmbim të pronës të paluajtshme të Komunës, i vitit 2019 që ka hyrë në fuqi, thuhet, Negocimi i ofertave nga Kryetari i Komunës, personat fizik dhe juridik mund të shprehin interes për marrje në shfrytëzim të pronës të Komunës te Kryetari i Komunës, mandej pika 2 thuhet, Kryetari i Komunës ka të drejtë pa zhvilluar procedura paraprake të negocioj ofertat e paraqitura nga palët e interesuara dhe të paraqet propozimin final për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës për miratim përfundimtar në Kuvendin e Komunës.

Tani t'i tregoj të drejtat e negocimit të Kryetarit e që njëra është kur vlera e investimit është së paku 10% e buxhetit të përgjithshëm për investime kapitale të vitit paraprak, do të thotë që ne e dim se në vitin paraprak investimet kapitale ka qenë diku rreth 9 milion euro e që investitorit i bie që nëse investon mbi 900,000.00€ nuk do të ketë nevojë fare të vije këtu në Kuvend dhe t'i bëhet atij investitori konkurrencë por këtë pikë e negocion Kryetari i Komunës.

Mandej rasti 2 është, në rast kur një investitor ka shprehur interesim për hapjen e një biznesi në interes të Komunës, si dhe pika 3 ku thuhet në rast kur nuk ka interesim për marrjen e pronës së Komunës në shfrytëzim nga palët së paku në 3 vitet e fundit. Do të thotë të tria këto pika i plotëson ngase sa unë di kjo pronë është në dhënie në shfrytëzim qe nja 4-5 vite dhe nuk e ka marrë askush këtë pronë, pra ka qenë në

mandatin e kaluar por që nuk e ka marrë askush që do të thotë se ka tri vite dhe i plotëson të gjitha këto tri pika, andaj nuk e di përse e keni sjellë këtu për ta shti në konkurrencë, kur publikisht Kryetari i Komunës ka thënë se aty në atë pronë do të ndërtohet Fabrikë e Autobusëve, t'ju them të drejtën ndoshta unë jam paksa optimist dhe mendoj se as atë ventilin e gomës së autobusit nuk dim të ndërtojmë, por nëse ai ka thënë se do ndërtojmë ne duhet t'i besojmë, po investon mirëpo çështja është përse e keni sjellë këtu dhe e keni fut në konkurrencë sepse është dashtë të negociohet dhe të në fund të sjellët këtu ku edhe do ta miratonim si Kuvend.

znj.Saranda Stublla - Uka, U.D. drejtoresh e DPKGJ, theksoi, unë e kam cekë edhe në Listën e veçantë të pronave të cilën e keni kundërshtuar, nuk e keni votuar, që në vitin e kaluar ka qenë ndërrimi i afatit kohorë për dhënie në shfrytëzim e që nuk është miratuar nga Ministria dhe është kthyer si e paligjshme për shkak se është miratuar në fund të vitit 2024 si Listë e veçantë dhe nuk kanë lejuar bëhet ndryshimi.

Sa i përket parcelës të cilën e kemi sjellë këtu për miratim, siç e dim të gjithë ne, komisioni përbëhet prej 2 asambleistëve qoftë nga pozita qoftë nga opozita, pastaj 2 anëtar nga Ekzekutivi i Komunës dhe 1 anëtar nga OJQ, kurse pse ne kemi dashtë ta sjellim në Kuvend që kjo pronë të jepet me Ankand publik ashtu siç e përcakton edhe Ligji, Ankandi publik është se kush jep më shumë e merr pronën gjë të cilat i dini edhe ju sepse i nderuar zotëri Ekrem keni qenë edhe ju në komisione të tilla për dhënie në shfrytëzim në mandatin e kaluar besoj, kështu që oferta vijnë te komisioni i cili pastaj i shqyrton ato dhe në fund me raport atë përzgjedhës që i'a rekomandojnë Kryetarit të Komunës si komision atëherë Kryetari i Komunës e nënshkruan Kontratën e që për dhënie në shfrytëzim afatgjatë sipas Ligjit pas nënshkrimit pastaj sërish kthehet në Kuvend për miratim final e që besoj se këto procedura do të ndjekën deri në fund.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, unë nuk e tejkalova këtë por e thash ashtu qysh Ligji e thotë se nëse ai (Kryetari i Komunës) publikisht e thotë se është një investitor strategjik, atëherë i ka dy mundësi, ta trajtoj si investitor strategjik por edhe e ka mundësinë tjetër, por ai nuk po don të marrë përgjegjësinë, pra nëse ka thënë ndokush që do të aplikoj dhe nëse e ka kërkuar atë pronë, e që drejtoresha paraprakisht na e tha se nuk e keni votuar, unë i them se është votuar nga ju si shumicë por që e ka kthyer Ministria pastaj, pra ne kemi thënë që nuk keni të drejtë në gjysmë të vitit ta ndryshoni listën dhe afatin e asaj prone nga afatshkurtër në afatgjatë, dhe për këtë e ka kthyer Ministria sepse nuk keni pas të drejtë, prandaj e keni votuar sepse votat i keni pas. Tash është për 99 vite por nuk mund t'i thuash ati po ta jap ty dhe ta fusësh në konkurrencë, Ligji i'a mundëson Kryetarit të Komunës të negocioj këtë sepse ai është investitor strategjik, andaj unë e thash përse nuk ka shkuar ai sipas ligjit.

Meqë kohë kemi dhe nuk jemi kallaballëk në këtë sallë unë po e lëshoj një incizim të shkurtër se çka ka thënë Kryetari për këtë pronë dhe projektin që e ceka më parë, sepse ndokujt mund të mos i kujtohet ose nuk e ka dëgjuar. *(lëshon incizimin e cekur)*, pastaj vazhdon, ndoshta më kuptove tani se çka deshta të them unë e nderuar drejtoresh, shembull, nëse ai fillon me 600 punëtorë dhe shkon deri në 2000 punëtor, unë e thash përse të futet në konkurrencë kur ai ka të drejtë të negocioj pronës dhe t'ia jep ati personi drejtë, kurse përmes ankandit hynë në konkurrencë, edhe unë mund të aplikoj dhe ta marrë atë pronë, madje qoftë me 2 euro më shumë që ofroj, pastaj shkoj edhe i kolosi lopët aty, prandaj a më mirë është ta negocioj atë pronë dhe ta merr ai investitor dhe të ndërton fabrikën dhe t'ui merre ata punëtorë sesa shembull unë që nuk kam mundësi ta bëjë atë.

Pra përse të futet në konkurrencë kur ligji i'a mundëson negocimin e dhënies në shfrytëzim të asaj prone e që pastaj vetëm sjellët në Kuvend dhe miratohet, pa komision, pa ankand publik pa procedura konkurrimi.

znj.Saranda Stublla - Uka, U.D. drejtoresh e DPKGJ, theksoi, i nderuar asambleist, përveç negocimit ligji i'a lejon edhe sjelljen e propozim vendimit për miratim këtu në Kuvend, dhe është lënë në dorën e asambleistëve, OJQ-së dhe Ekzekutivit të vlerësoj se kush do ta fitoj atë pronë.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, unë u mundova të jem sa më i kjartë, përndryshe unë nuk mund t'ia ndaloj as asgjë atij, por unë e thash qysh shkon mbarë edhe mirë. Nëse ai (Kryetari i Komunës) del në televizion publik, madje hyri edhe më thellë kur e ka thënë që kjo pronë në seancën e fundit i është dhënë në shfrytëzim atij personi , e që ishte rrenë sepse nuk i është dhënë ngase tani nuk do të sjellej këtu sërish për votim, ne që kemi qenë në Kuvend mandatin e kaluar e dim se nuk i është dhënë, mirëpo nëse atij i është thënë që të bëhet gati për atë pronë sepse afati ka qenë për 10 vite kurse ai person ka kërkuar afat më të gjatë për 99 vite, dhe tani ai person përgatitet kurse tani e fusni në konkurrencë, mund ta merr dikush tjetër atë pronë, mua nuk më duket e udhës kjo, kjo ishte.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, në bazë të asaj që dëgjuam nga parafolësit atëherë kjo pronë shpallet në ankand publik dhe me automatizëm kanë të drejtë të gjithë të interesuarit të konkurrojnë.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit dhe Komitetit për Politikë dhe Financa konstatoi se nga 9 anëtarët e Komitetit, me 6 vota PËR, 2 vota KUNDËR, 1 votë E PËRMBAJTUR, Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim të Propozim vendimit për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës-Njësia kadastrale P-202-3, Zona Kadastrale Lupç i Poshtëm (pika 4), sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

Kryesuesi i Kuvendit, vazhdoi, gjithashtu me radhë është edhe propozim vendimi për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim, drejtoresha e DPKGJ veç se na njoftoj për formën se si do të procedohet dhe vendoset në Kuvend për të gjitha pikat, andaj nuk e shohë të nevojshme ta merr fjalën sërish, prandaj e hedh në votim se a pajtohem që vazhdohet në atë formë.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit dhe Komitetit për Politikë dhe Financa konstatoi se nga 9 anëtarët e Komitetit, me 6 vota PËR, (të tjerët nuk votuan), Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim të këtij Propozim vendimi për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim (pika 4.1), sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

5. Propozim vendim për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-1339-0, Zona Kadastrale Orllan

5.1. Propozim vendimi për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave për dhënie në Shfrytëzim

znj.Saranda Stublla - Uka, U.D. drejtoresh e DPKGJ, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, theksoi, pra si pikë të rendit të ditës e kemi edhe propozim vendimin për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës, Njësia kadastrale P-1339-0, Zona Kadastrale Orllan. Po ashtu për këtë propozim vendim kemi edhe propozimin vendimin për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim të kësaj prone, andaj kërkoj nga ana juaj që ta përkrahni dhe t'ia rekomandoni Kuvendit për miratim të këtyre dy propozim vendimeve.

z.Artrit Mulliqi, theksoi, në emër të Grupit të LVV rekomandojmë që kjo pikë e rendit të ditës të vazhdoj tutje për nesër në seancën e Kuvendit.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, këtë pikë të rendit të ditës e përkrahim edhe ne Grupi i LDK, është paksa më e sqaruar dhe është për 10 vite dhënie në shfrytëzim me qira, kështu që e përkrahim.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, meqë nuk ka të lajmëruar tjerë për të marrë fjalën rreth kësaj pike, atëherë e hedh në votim që t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim, fillimisht propozim vendimin nga pika 5 e rendit të ditës.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit dhe Komitetit për Politikë dhe Financa konstatoi se Njësëri me 9 vota PËR, Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim të Propozim vendimit për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës, Njësia kadastrale P-1339-0, Zona Kadastrale Orllan (pika 5), sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

Kryesuesi i Kuvendit, vazhdoi, sipas procedurës paraprake, tani e hedh në votim edhe propozim vendimin për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim të kësaj prone, pikë për të cilën nuk besoj që kemi ndonjë paqartësi sepse kishte unanimitet, por për hire të procedurave e vë në votim edhe këtë që t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit dhe Komitetit për Politikë dhe Financa konstatoi se Njësëri me 9 vota PËR, Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim të këtij Propozim vendimi për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim (pika 5.1), sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

6. Propozim vendim për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-00459-0, Zona Kadastrale Podujevë

6.1. Propozim vendimi për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim

znj.Saranda Stublla - Uka, U.D. drejtoresh e DPKGJ, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, theksoi, pra pikë të rendit të ditës po ashtu kemi edhe Njësinë kadastrale për dhënie në shfrytëzim me numër të parcelës 459-0 Zona Kadastrale Podujevë, kjo parashihet për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër, në këtë parcelë po ashtu janë dy Lokale të Komunës të cilat parashihen për dhënie në shfrytëzim. Po ashtu kemi edhe propozim vendimin për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim, andaj kërkoj që edhe këto pika t'i përkrahni dhe t'ia rekomandoni Kuvendit për miratim.

z.Haki Rudari, theksoi, në emër të Grupit të LVV e përkrahim këtë propozim vendim dhe i rekomandojmë Kuvendit të Komunës që nesër në seancë ta shqyrtoj dhe të merr një vendim përfundimtar.

znj.Alisa Jetullahu, theksoi, edhe ne në emër të grupit të LDK e përkrahim këtë pikë të rendit të ditës.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, pyetje për drejtoreshën e DPKGJ, këto dy lokale siç e dim janë afër ish burgut famëkeq, dhe nuk po merr askush në shfrytëzim me qira, përse dhe a ka mundësi të bëhet ndonjë investim i vogël aty sepse vendi është shumë i mirë, pra ato objekte janë paksa të vjetra por me një investim / renovim të vogël, sigurisht që pastaj do t'i marrë në shfrytëzim dikush, e mandej të ketë përfitim edhe Komuna më shumë. Sa kujtoj ato lokale kanë qenë në procedurë edhe para 3-4 viteve dhe nuk i ka marrë askush në shfrytëzim, kështu që ndoshta do të ishte mirë të bëhej ndonjë renovim dhe pastaj të lëshohen me qira, përndryshe nuk e di përse atë vend aq të mirë nuk e merre dikush me qira, a janë objektet vjetra apo çka.

znj.Saranda Stublla - Uka, U.D. drejtoresh e DPKGJ, theksoi, nuk kemi planifikuar ndonjë investim në ato lokale por besoj që palët që aplikojnë secili prej tyre e dinë gjendjen e atyre lokaleve dhe e dinë se do të investojnë në ato lokale në qoftë se e marrin në shfrytëzim.

Përse nuk kanë aplikuar në vitet e kaluara nuk e di, por shpresoj që këtë vit do të aplikojnë dhe do t'i marrin në shfrytëzim ato lokale.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, a ka ndonjë kontest në atë pronë ose ndonjë uzurpim apo diçka të ngjashme. **znj.Saranda Stublla - Uka**, U.D. drejtoresh e DPKGJ, vazhdoi, përgjigje parafolësit, jo nuk ka ndonjë kontest në atë pronë, për më shumë parcelat që sjellën në Kuvend për dhënie në shfrytëzim asnjë prej tyre nuk kanë ndonjë kontest gjyqësorë apo janë të uzurpuara sepse Ligji përkatës për dhënie në shfrytëzim na e ndalon që të japim në shfrytëzim, kështu që çdo parcelë dhe çdo lokal që e sjellim në Kuvend për miratim paraprak për dhënie në shfrytëzim, është i lirë dhe mund të zhvillohen procedurat përkatëse për dhënien në shfrytëzim.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, atëherë e hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës që t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit dhe Komitetit për Politikë dhe Financa konstatoi se Njësëri me 9 vota PËR, Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim të Propozim vendimit për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës, Njësia kadastrale P-00459-0, Zona Kadastrale Podujevë (pika 6), sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

Kryesuesi i Kuvendit, vazhdoi, gjithashtu kemi edhe propozim vendimin për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim, andaj e hedh në votim edhe këtë pikë të rendit të ditës që t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit dhe Komitetit për Politikë dhe Financa konstatoi se Njësëri me 9 vota PËR, Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim të këtij Propozim vendimi për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim (pika 6.1), sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

7. Propozim vendim për formimin e Komisionit për shqyrtimin e ankesave në procedurën e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës

znj.Saranda Stublla - Uka, U.D. drejtoresh e DPKGJ, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, theksoi, pra në këtë pikë të rendit të ditës kemi edhe propozim vendimin për formimin e Komisionit për shqyrtimin e ankesave në procedurën e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës.

Sipas Ligjit, parashihet edhe formimi i komisionit për ankesa dhe atë me mandat 2 vjeçar, komision i cili shqyrton të gjitha ankesat të cilat kanë të bëjnë me dhënien e pronave në shfrytëzim.

Po ashtu edhe për këtë Komision kemi bërë thirrjen publike për OJQ-të që parashihet me Ligj që të jetë një anëtar nga radhët e OJQ, 2 nga Ekzekutivit të Komunës dhe 2 nga Kuvendi i Komunës, andaj kërkoj nga ana juaj që ta përkrahni dhe t'ia rekomandoni Kuvendit për miratim në seancën e nesërme.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën rreth kësaj pike të rendit të ditës, nëse jo po besoj që jemi të pajtimit që edhe kjo pikë e rendit të ditës t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim, andaj e hedh në votim.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit dhe Komitetit për Politikë dhe Financa konstatoi se Njësëri me 9 vota PËR, i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim të këtij Propozim vendimi për formimin e Komisionit për shqyrtimin e ankesave në procedurën e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

8. Propozim vendim për dhënie në shfrytëzim afatgjatë Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës, objektin e ish Emergjencës së Qytetit

z.Isak Shabani, Kryesues i Komitetit, theksoi, në këtë pikë të rendit të ditës kemi propozim vendimin për dhënie në shfrytëzim afatgjatë Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës, objektin e ish Emergjencës së Qytetit, andaj ftoj propozuesin e kësaj pike të paraqet arsyeshmërinë e këtij propozim vendimi drejtoreshën e DSHMS.

znj.Lirie Hoti - Rama, U.D. drejtoresh e DSHMS, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, theksoi, siç e përmendi edhe Kryesuesi i Kuvendit, propozim nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale është dhënia në shfrytëzim e ish objektit të Emergjencës për një periudhë afatgjate që është cekur 30 vite i cili do t'i destinohet Shërbimit Mendor në kuadër të SHSKUK-së për arsye siç edhe ju e dini që objekti i tyre është rrënuar për nevojat e ndërtimit të Rezidencës për të moshuar para disa viteve, sa kujtoj në vitin 2024, kështu që prej asaj periudhe këta janë bartë përkohësisht në ambientet e QKMF-së, mirëpo është konstatuar që aty nuk plotësohen të gjitha kushtet e nevojshme, por edhe kushtet minimale për realizmin e shërbimeve ndaj atij grupi, kështu që objekti i vetëm që kemi mundur t'iu bëjmë zgjidhje është objekti i ish Emergjencës. Në dokumentacionin të cilin e keni paravetës është bashkëngjitur edhe Kërkesa e SHSKUK-së mirëpo edhe Raporti dhe Vendimi nga QKMF që ky objekt nuk i duhet për shfrytëzim më QKMF-së, gjithashtu edhe Kërkesa e SHSKUK-së me arsyetimin e tyre, kështu që nga ana juaj ju ftoj të gjithëve që nesër ta përkrahni këtë vendim.

z.Artrit Mulliqi, theksoi, në emër të Grupit të LVV rekomandojmë që kjo pikë e rendit të ditës të vazhdoj për shqyrtim nesër në seancën e Kuvendit të Komunës.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, edhe ne Grupi i LDK e përkrahim që kjo pikë e rendit të ditës të shkoj në Kuvend dhe normale edhe në seancën e Kuvendit do ta përkrahim.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, meqë nuk shohë dikë tjetër që kërkon fjalën e hedh në votim që kjo pikë e rendit të ditës t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit dhe Komitetit për Politikë dhe Financa konstatoi se Njëzëri me 9 vota PËR, i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim të këtij Propozim vendimi për dhënie në shfrytëzim afatgjatë Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës, objektin e ish Emergjencës së Qytetit, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

9. Propozim vendim për ngritjen e Komisionit Komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Kompania Regjionale e Mbeturinave “Pastrimi” Sh.A.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, meqë në vijim kemi 4 propozim vendime për ngritjen e komisioneve të aksionarëve të 4 ndërmarrjeve publike, lus Nënkryetarin e Komunës që fjalën hyrëse ta paraqet për të gjitha këto pika të rendit të ditës meqë janë të një natyre të njëjtë, e pastaj pas diskutimeve për këto pika të rendit të ditës, votimi do të bëhet veç e veç, natyrisht për këtë që e ceka nëse ka pajtim të të gjithëve.

z.Fahri Restelica, Nënkryetar i Komunës, me pajtimin e anëtarëve të KPF-së, e paraqiti fjalën hyrëse rreth pikave të rendit të ditës që kanë të bëjnë me formimin e Komisioneve të Aksionarëve të 4 Ndërmarrjeve Publike në këtë pikë të rendit të ditës dhe pikat e renditura në vijim (10; 11; 12.), theksoi, bazuar në nenin 58 shkronja h) ndërlidhur me nenet 5 shkronja c), 11, 12 shkronja d) dhe 17 shkronjat f) dhe l) të Ligjit nr.03/L-040 për vetëqeverisje lokale, nenit 5.2 të Ligjit nr.03/L-087 për ndërmarrjet publike, Ligjit nr.04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ndërmarrjet publike nr.03/L-087, nenin 61 paragrafi 1.8 ndërlidhur me nenin 3 paragrafi 1.3, nenet 14, 15 paragrafi 2.4 dhe nenit 19 paragrafët 1.6 dhe 1.12 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/18, Kuvendit të Komunës së Podujevës i propozohen që të ngritet Komisioni komunal i aksionarëve të Ndërmarrjes

Publike KRM “Pastrimi” sipas propozim vendimit përkatës, pastaj kemi propozim vendimin për ngritjen e Komisionit komunal të aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Lokale “Stacioni i Autobusëve”, mandej kemi po ashtu propozim vendimin për ngritjen e Komisionit komunal të aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Lokale “Eko-Llapi”, si dhe kemi propozim vendimin për ngritjen e Komisionit komunal të aksionarëve të Ndërmarrjes Publike për Banim.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, për këto pika të rendit të ditës, nëse jeni të pajtimit e hapi debatin, ndërsa votimi siç e ceka do të bëhet veç veç për secilën.

z.Haki Rudari, theksoi, në emër të grupit të LVV e përkrahim dhe i rekomandojmë kuvendit të Komunës nesër për shqyrtim dhe për marrjen e vendimeve përfundimtare.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, unë jam kundër këtyre propozimeve që komisionet në fjalë të ngritën kështu në këtë formë. E kam bërë një lloj hulumtimi e që shembull nuk e di përse tek ne nuk bëhet kjo kur bëhen gjithkund aksionarë, shembulli është i Zagrebit dhe i Linzit, të cilat i bëjnë shembull “Linz AG” dhe “Zagreb Holding”, ku Komuna është aksionare 100% por që prej Kuvendi i dërgojnë dy anëtar dhe formojnë vetëm një komision të aksionarëve dhe ai komision raporton për të gjitha Ndërmarrjet, e jo sikur tek ne shembull, përjashtoj “Pastrimin” e cila sa duket është pran bankrotimit sepse shoh që tek ne në fshatin ku jetoj nuk po i marrin mbeturinat, por tek kjo Ndërmarrja Banesore e cila u fut si pikë shtesë, unë nuk e di a ka ndonjë punëtor apo jo, unë nuk e di e as nuk njoh ndonjë punëtor te kësaj Ndërmarrje, në ka kohë që ka qenë një e cila sa jam në njohuri ka shkuar në pension kurse në anën tjetër aksionarët do të emërohen, prandaj nuk po di sepse edhe ne kur po i votojmë ata aksionar nuk po japin raporte në Kuvend e që e kan të detyrueshme me ligj.

Ndoshta do të ishte më mirë të bëhen bashkë dhe të zgjedhen të NPL “Eko-Llapi” e cila më duket është paksa më e mirë si Ndërmarrje sepse po funksionon më mirë, pra të bëhen njëjtë, kjo sepse këtu shembull patëm 4 Ndërmarrje Publike, ne t’i votojmë këtu 6 anëtarë, e ata anëtarë pastaj pak më vonë do t’i kërkojnë edhe paratë / kompensimin e tyre mandej apo pagën minimale të tyre e që na kushton si Komunë, por ata të gjashtit shkojnë atje dhe e zgjedhin nga një Kryeshef, në 4 Ndërmarrje nga 1 Kryeshef, nga 1 Zyrtar kryesor financiar, nga 1 arkëtar, nga 1 sekretar, po shkon goxha gjerë, përndryshe nëse dëshirojmë vetëm t’i punësojmë disa persona, madje disa që nuk kanë fare nevojë, ne mund t’i dërgojmë, mirëpo unë më të rrugës do e shihja t’i bëjmë vetëm një vend dhe t’i dërgojmë 2 aksionarë nga Kuvendi, por të dërgohen të përgjegjshëm e që t’i përmbahen ligjit i cili obligon që për çdo vit të vijnë të raportojnë në Kuvend për ato Ndërmarrje.

Ne një ose dy ndihma financiare i kemi ndarë NPL ‘Stacioni i Autobusëve’ dy vitet e kaluara nga 30,000.00€ dhe nuk e dim së pari se a është funksional apo jo ai Stacion sepse po shohim që Autobusët po vijnë deri në pjesën e naltë të qytetit, prandaj e ceka se nuk e dim a është apo jo funksional ai Stacion i Autobusëve, pastaj nuk e dim a e ka rritur ose zvogëluar buxhetin apo nuk kanë fare paga ata perona që janë zgjedhur atje, ne nuk e dim sepse duhet të vijnë me raportime në Kuvend.

Nuk është marre të thuhet shembull të thuhet kjo kompani e jona nuk ka mjete, kemi bërë kështu e ashtu, dhe mandej si Kuvend të ndërmarrim iniciativë dhe t’i ndajmë mjete buxhetore në mënyrë që t’i merr këmbët paksa e pastaj të punojë mbarë e mirë.

Përndryshe në këtë formë, veç të bëhet “yrysh” që të bëhen ato komisione dhe disa prej atyre personave t’i marrin nga 2-3 paga e disa tjerë fare, ne mund t’i votojmë, nuk është problem dhe nuk kam kundër asgjë, por mund të them se unë nuk do të shkoja në komision të tillë sepse ku të shkohet tek një Ndërmarrje publike ku aty nuk ka asnjë punëtor, mandej të ndodh të thot dikush se jam shef i një Ndërmarrje, mirëpo aty ska asnjë punëtor, pra shef i kujt, i asfaltit e banesave a.

Pra unë do ta bëja vetëm një komision të aksionarëve për të gjitha këto Ndërmarrje, të cilin do ta aktivizoja goxha mirë dhe në fund do të kërkoja përgjegjësi sepse kur do i thirrnim për raportim këtu në Kuvend pastaj edhe tek kryeshefi do të shkonin dhe t’i rrinin pak më gati kësaj pune ku do t’i thonin se

neve na ka votuar Kuvendi i Komunës andaj t'iu rrini gati punëve sepse ne do të raportojmë në Kuvend të Komunës, kështu që unë jam kundër.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, para se të fillojmë me votime, unë me një pjesë të fjalimit të parafolësit zotëri Rrahmani pajtohem, por besoj që së shpejti pritet të sjellët Plani i Punës së Kuvendit për vitin 2026 pasi që Grupi punues bërë një punë e që pritet vetëm edhe një takim të mbahet dhe aty është paraparë raportimi i këtyre nga Aksionarët për këto ndërmarrje Publike dhe besoj se do të raportojnë, kështu që unë i hedh në votim në formën siç kanë ardh. Pra fillimisht e vë në votim propozim vendimin për ngritjen e Komisionit Komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Kompania Regjionale e Mbeturinave “Pastrimi” Sh.A. që t’i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit dhe Komitetit për Politikë dhe Financa konstatoi se nga 9 anëtarët e Komitetit, me 5 vota PËR, asnjë votë KUNDËR, asnjë votë TË PËRMBAJTUR, (të tjerët nuk votuan), Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim të këtij Propozim vendimi për ngritjen e për ngritjen e Komisionit Komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Kompania Regjionale e Mbeturinave “Pastrimi” Sh.A., sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

10. Propozim vendim për ngritjen e Komisionit Komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Lokale Stacioni i Autobusëve Podujevë Sh.A

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, tani kemi propozim vendimin për ngritjen e Komisionit Komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Lokale Stacioni i Autobusëve Podujevë Sh.A të cilin e hedh në votim që t’i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit dhe Komitetit për Politikë dhe Financa konstatoi se nga 9 anëtarët e Komitetit, me 6 vota PËR, asnjë votë KUNDËR, asnjë votë TË PËRMBAJTUR, (të tjerët nuk votuan), Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim të këtij Propozim vendimi për ngritjen e Komisionit Komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Lokale Stacioni i Autobusëve Podujevë Sh.A, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

11. Propozim vendim për ngritjen e Komisionit Komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Lokale “Eko-Llapi” Sh.A Podujevë

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, tani votojmë që t’i rekomandohet Kuvendit për shqyrtimin e Propozim vendimit për ngritjen e Komisionit Komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Lokale “Eko-Llapi” Sh.A Podujevë

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit dhe Komitetit për Politikë dhe Financa konstatoi se nga 9 anëtarët e Komitetit, me 6 vota PËR, asnjë votë KUNDËR, asnjë votë TË PËRMBAJTUR, (të tjerët nuk votuan), Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim të këtij Propozim vendimi për ngritjen e Komisionit Komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Lokale “Eko-Llapi” Sh.A Podujevë, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

12. Propozim vendimi për ngritjen e Komisionit Komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike për Banim Sh.A. Podujevë

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, gjithashtu kërkoj që të deklarohemi me votë për rekomandim për shqyrtim në Kuvend të Propozim vendimit për ngritjen e Komisionit Komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike për Banim Sh.A. Podujevë.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit dhe Komitetit për Politikë dhe Financa konstatoi se nga 9 anëtarët e Komitetit, me 6 vota PËR, asnjë votë KUNDËR, asnjë votë TË PËRMBAJTUR, (të tjerët nuk votuan), Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim të këtij Propozim vendimi për ngritjen e Komisionit Komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike për Banim Sh.A. Podujevë, sipas materialit përkatës të prezantuar dhe shpërndarë në këtë mbledhje të KPF-së.

Duke i falënderuar të pranishmit për pjesëmarrje dhe kontributin e dhënë rreth kësaj mbledhje, Kryesuesi i Komitetit e konstaton të përfunduar këtë mbledhje, duke i njoftuar se Konstatimet e rekomanduara nga kjo mbledhje sot do të procedohen në Kuvendin e Komunës për shqyrtim.

Mbledhja përfundoi në orën 11:25

**Procesverbalin e mbajti;
Enis Sheholli**

**Nr.Prot.01-060/04-0018628/26
Podujevë,
30 mars 2026**

**Kryesuesi i Kuvendit - Komitetit
Isak Shabani**